



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 55, datë 22.12.2020

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE  
RENDITJES SË KANDIDATËVE TË LEJUAR PËR VENDIN VAKANT NË  
GJYKATËN KUSHTETUESE**

Në mbështetje të pikës I të nenit 149/d të Kushtetutës, të neneve 229, 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme për shkak të mbarimit para kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVENDËSKRYETARE

Vitore TUSHI

